



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LEGJISLATURA VI**

**Sesioni Pranveror**

**Komisioni për Integrime Evropiane**  
**Mbledhja nr. 40**  
**Prishtinë, më 06.03.2019 në ora 16:30**  
**Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 302**

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE**

**Në mbledhje morën pjesë:** Blerta Deliu-Kodra, Armend Zemaj, Fikrim Damka, Ismajl Kurteshi, Fatmire Kollçaku, Zenun Pajaziti, Visar Ymeri, Donika Kadaj-Bujupi dhe Milaim Zeka.

**Mungoj:** Ismet Beqiri dhe Adem Hoxha

**Nga Stafi Mbështetës i Komisionit:** Ahtere Loxha dhe Safet Beqiri.

**Mbledhjen e kryesoi;** Blerta Deliu Kodra, Kryetare e Komisionit.

**Kryetarja e Komisionit** pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen e Komisionit me këtë.

**Rend Dite:**

- 1. Shqyrtimi i Projektligjin nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësit dhe kompetencat e Delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.**

**Kryetarja** lidhur me Projektligjin tha se çështjet e rregulluara dhe adresuara me këtë Projektligj, nuk janë të rregulluara me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Andaj, konstatoj se Projektligji nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësit dhe kompetencat e Delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

**Ismajl Kurteshi** tha se ky projektligj nuk rregullohet me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe është një praktikë që po ndodhe për herë të parë edhe me legjislacionin tonë, prandaj nuk e dimë edhe ku është baza e këtij ligji.

Zakonisht janë zhvillu bisedimet por nuk kemi pas ligje të caktuara për zhvillimin e bisedimeve, dhe për aq sa kam arrit me e pa në këtë ligj, nuk përcaktohen vijat e kuqe të ju themi, të cilat e kishin bërë të pamundur që delegacioni shtetëror ose institucionet kushtetuese të cilat sipas ligjit edhe ata duhet të jenë pjesë e bisedimeve, i ju pamundësohet që të bisedojnë për çështjet të cilat nuk do duhej të bisedohej. Kur është fjala të institucionet, domethënë është ky delegacion shtetëror dhe pastaj thuhet që edhe institucionet kushtetuese do të bisedojnë, sipas kësaj, atëherë eksiton rreziku që të zhvillohen bisedime paralele siç edhe po ndodh, do të thotë me një anë Presidenti bisedon, në anën tjetër ky delegacioni shtetëror shkon dhe takohet atje në Bruksel me dikë tjetër dhe bazuar në informatat që i kemi, nuk e din as delegacioni shtetëror atë që flet Presidenti, cilat janë pikat për të cilat diskutojnë dhe ku kanë arritur këto bisedime, po edhe e kundërta ndodhë, prandaj e konsideroj që vërtet kjo çështje nuk do të duhej të kishte ndodh fare kështu siç po ndodh. Ne i kemi vërejtjet tona edhe për platformën edhe për delegacionin në përgjithësi, si subjekt politik.

**Fatmire Kollqaku:** Vet fjala „Leg specialis” nënkupton që ky ligj nënkupton që edhe pse kemi pasur marrëveshje ndërkombëtare, edhe pse e kemi kushtetutën nënkupton mbivendosjen, siç është tendenca edhe e delegacionit më u mbivendos mbi institucionet. Përndryshe, unë mendoj që ky delegacion është formuar vetëm për me legjitimuar atë që fare ka bërë Presidenti deri tani, sepse ne asnjë herë nuk e dimë deri ku ka shkuar ajo marrëveshje, deri ku ka jep zotime, sepse deri tani e ka udhëheq krejt këtë proces dhe atij i është nevojitur një lloj grupi i tillë që ma shumë është teknik, dhe se atij i është nevojitur legjitimiteti nga Kuvendi, sepse e ka ditur që në formatin qysh e ka zhvilluar deri tani, nuk do ta merr atë legjitimitet, dhe tani ai kinse në një farë forme është tërhequr pak për t'i lënë hapësirë, kinse Kuvendit.

Por krejt kjo çka po tregohet edhe ç'farë po shohim prej njerëzve tjerë që kanë pasur një përfshirje në këtë grup, e kane pa që aty veç tashme pothuajse të gjithat janë të parashkuara, dhe të jesh pjesë e një delegacioni ku vendimet veç janë marre dhe të jesh vetëm si figurë, nuk kane pranuar disa zyrtar të larte që janë nga Vetëvendosja. Mirëpo neve nuk na duhet “Leg Specialis”, asnjë ligj që e mbisundon gjithë legjislacionin e miratuar deri tani. Prandaj duke qenë në atë vijë që ky delegacion vetëm sa do ti shërbej legjitimitetit të dialogut të zhvilluar deri tani nga Presidenti, i cili si duket edhe ka shkuar larg në zotime dhe tash do të jetë e pamundshme edhe të tërhiqemi në shumë çka, ne nuk do të marrim pjesë në këtë votim.

**Visar Ymeri** tha, dëshiroj ti jap disa sqarime për sa i përket ligjit, sepse unë mendoj që është keqkuptua shpesh prej titullit të tij, kur nuk është lexuar asnjëherë titulli i tij i plotë. Pra, ky nuk është ligj për dialogun, është ligj për delegacionin, ligj i cili e rregullon mënyrën se si themelohet delegacioni, e rregullon vendimarrjen brenda delegacionit, veçanërisht e rregullon marrëdhënien që delegacioni e ka me institucionet tjera kushtetuese, pra me zyrën e Presidentit, zyrën e Kryeministrit, etj.

Ligji nuk e ka për qëllim as ta minimizoj politikisht rrugën e negociatës, çështje të cilat fliten ose jo, sepse ato barten në platformë dhe janë të radhitura në platformë, e as nuk ka për qëllim të anuloj sepse nuk mundet edhe po ta kishte për qëllim të anuloj asnjëherë

prej institucioneve kushtetuese. Ligji i jep kompetenca edhe përgjegjësi delegacionit shtetëror që për sa i përket dialogut me Serbinë të jetë organi vendim marrës dhe ky mandatohet nga Kuvendi. U tha nga parafolësit, dhe është diskutuar edhe në seancë që ky ligj bie ndesh me atë që është qëllimi i ligjit, që janë vërejtje që mund të jenë të qëndrueshme karshi procesit të dialogut, po që nuk kanë fare të bëjnë me ligjin, përkundrazi ligji është një ligj i veçantë, sepse e rregullon në mënyrë të veçantë një çështje të veçantë, kjo është e vërteta për ligjin, pra dialogu me Serbinë është parë si një angazhim i veçantë i institucioneve të Republikës, dhe në këtë drejtim, propozimi ka qenë që përmes rezolutës përgjegjësinë për dialogun ta marr Kuvendi dhe të mos t'i lihet as Presidentit e as Qeverisë. Pra, kemi pas një situatë ku askush nuk u pajtua që Presidenti të jetë drejtues i delegacionit dhe një situatë tjetër ku Kryeministri aktual ka thënë nuk dua të merrem me këtë çështje dhe në këtë drejtim është pa nevoja dhe mundësia që këtë fazë të dialogut ta organizojmë në mënyrë të veçantë, pra ndryshe përmes delegacionit shtetëror dhe kjo është ajo çka ka ndodh në Kuvendin e Republikës së Kosovës me miratimin e Rezolutës dhe pastaj me miratimin e ligjit në lexim të parë.

Dua t'i shpjegoj edhe dy amendamentet që i kemi përpara dhe të dyja janë pak a shumë ndërhyrje teknike në ligj. Aty e keni pa besoj se njëri prej neneve ka një mos përputhje me anëtarët e delegacionit, mos përputhje në mes të numrit që është i përshkruar me fjalë, ku thuhet njëmbëdhjetë, dhe pastaj numrit të anëtarëve delegacionit të cilët në kllapa është dymbëdhjetë dhe kjo është dashtë të ndryshohet në dymbëdhjetë, sepse realisht dymbëdhjetë anëtar është parapa me pas delegacioni shtetëror. E dyta është që kur vjen puna te vendim marrja e delegacionit, pra pas dy tentimeve për vendimmarrje unanime parashihet që të jenë dy të tretat, aty gabimisht është përmbledhur që të jenë dy të tretat e të pranishmeve, ndërkohe që duhet të jetë dy të tretat e anëtarëve të delegacionit. Sa i përket marrëdhënies që delegacioni i ka me dy instanca kryesore kushtetuese, pra me Presidentin në njërën anë dhe Kryeministrin në anën tjetër, është e paraparë në ligj që kur ka takime në të cilat njeri prej tyre është i domosdoshëm, p.sh. duhet të jetë edhe Presidenti, atëherë Presidenti as nuk mund të shkoj në takime pa u bashkërenduar në një fare mënyre me delegacionin shtetëror dhe as nuk mund të jetë i vetëm në këto takime pa dy bashkë drejtuesit, njëjtë është edhe për kryeministrin.

Njëjtë është edhe për ndonjë udhëheqës prej ndonjë prej institucioneve që është e nevojshme të marrin pjesë në dialogun me Serbinë, pra këtu e kemi komponentën ose mekanizmin e bashkërendimit.

Kur është puna për vendim marrje siç ka qenë për shembull për platformën politike të dialogut, atëherë me ligj parashikohet që kjo të jetë vendim marrje e delegacionit në konsultime me dy instancat tjera, ose me këto organet tjera kushtetuese të Republikës së Kosovës. Pra nuk është të paktën me ligj, me platformë edhe me rezolutë, delegacioni shtetëror nuk i mbivendoset as Presidentit. Delegacioni shtetëror sa i përket dialogut me Serbinë është i barabartë me ta. Ndërkohë që këta duhet t'i koordinojnë veprimet e tyre për sa i përket dialogut me delegacionin shtetëror, kjo është e parapamë me ligj.

Kam dëgjuar edhe nëpër media që thonë, po mundet me shkel ligjin. Unë nuk e përjashtoj që mundet me shkel ligjin, mirëpo nuk mund tash me mundësi edhe spekulime që ligji mund të shkelet në të ardhmen, me thënë që ligji është i pa pranueshëm, sepse ligji mund te shkelet, secili ligj mund të shkelet, pra në këtë drejtim konsideroj që do të kishte me qenë mirë, dhe ju ftoj që ta votoni ligjin, sepse ia shton peshën Kuvendit të Republikës së Kosovës e veçanërisht opozitës që merr pjesë në delegacion, por edhe në seancat e Kuvendit, në komisione mbikëqyrëse e kështu me radhe sa i përket dialogut.

**Milaim Zeka:** Unë si deputet, jo si qëndrim i NISMA-së i bashkangjitem në mënyrë absolute qëndrimin të VETËVENDOSJE-s, edhe unë do të votoj kundër dhe arsyet e mia janë këto: E para, është hipokrizi me kritiku ne opozitën pse kane thirr me 5 Mars seancë të jashtëzakonshme, e tash ne pozita me thirr seancë te jashtëzakonshme nesër me 7 Mars, natën e zjarreve. Kjo është shumë pafytyrësi dhe nuk votoj kundër vetes time sepse unë e kam kritikuar opozitën për këtë. E dyta, dëgjova me shumë vëmendje ekspozenë e kolegut tim Visar, po shihet që ky ligj është i ardhur nga Partia Social Demokrate, e jo nga Qeveria.

Unë jam gjysmë i shqetësuar për finalen e bisedimeve për arsye se frikohem shumë që presioni final mbi deputet për votimin e një marrëveshje të keqe ndaj Kosovës ka me qenë i madh nga Ambasadorët e vendeve perëndimore.

Kështu që unë e kam frikën te finalja, se çdo marrëveshje ka me kaluar në Parlamentin e Kosovës, dhe kemi me votuar ne. Edhe një vërejtje, sepse nuk kemi situatë të jashtëzakonshme dhe nuk po kuptoj cila është logjika me thirr seancë të jashtëzakonshme për një ligj të tillë nesër. Tash e mora ligjin edhe e shfletova, dhe një detaj i vogël më ra ne sy, do të caktohet një anëtar nga shoqëria civile dhe kush do e cakton këtë anëtar delegacioni? Nuk thuhet me propozim, shoqëria civile duhet të propozoj dhe në qoftë se vetë delegacioni e bënë një emërim, atëherë këto janë emërimet nuk janë propozime. Në qoftë se Veton Surroi, veç ka hyrë përderisa e kemi parë në Kuvend të Kryetari i Kuvendit është në listë atje për me ardhur, e ne dalim para aktit të kryer. Unë për veti, as nuk e votoj sot, e as nesër, as pasnesër një ligj të tillë. Ky është qëndrimi im absolut, personal, me të cilit i bashkangjitem VETËVENDOSJE-s dhe shpresoj edhe LDK-së.

**Armend Zemaj:** Me thënë të drejtën edhe prania ime është ma shumë në aspektin e punës edhe kolegialitetit, çfarë e kemi si anëtar të komisionit se sa arësyeshmërinë pse është dashur me thirr një mbledhje urgjente dhe sidomos një seancë urgjente duke e marr parasysh që ky ligj akoma nuk ka kaluar në procedura të rregullta .

Ky ligj edhe më shumë e përçanë dhe e minon konsensusin nacional, edhe arsyeshmëria e brendshme çfarë i cakton në momentin kur preket kompetenca Kushtetuese.

Kompetenca kushtetuese është prek me këtë projektligj, duke filluar nga përfaqësimi i Republikës së Kosovës, që tentohet t'i bartet një institucioni të ashtu quajtur shtetëror. Brenda delegacionit shtetëror kemi kompetenca të përziera kushtetuese në nivele të ndryshme që i tejkalon edhe ndarjen e pushteteve, po flas për sistemin çfarë e kem na këtu në Republikën e Kosovës.

Paramendoni, bashkë drejtuesi i delegacionit është Kryetar i një komune, deputetët e Kuvendit të Kosovës janë me Ministra, që është një kompetencë e cila është hequr me Kushtetutën e Republikës se Kosovës dhe pala e trete që thuhet që i merr kompetencën tjetër të përfaqësimit, çoftë Kryeministrit, çoftë Presidentit të vendit, nuk qëndron dhe kjo do të vazhdojë me avazin e vjetër. Për Lidhjen Demokratike të Kosovës është i pa pranueshëm, mbetet kundër Kushtetues, koha do ta dëshmon dhe do ta thëllon edhe përçarjen, do ta thëllon edhe dobësimin e konsensusit nacional, në këtë formë çfarë po vazhdohet, kriza do të thëllohet edhe arsyeshmëria për me shkua në zgjedhje me i zgjidh këto elemente dhe me e zgjidh këtë destruktivitet kushtetues, ketë përçarje të madhe, së pari të koalicionit qeverisës dhe larg bashkëpunimit me opozitën. Nuk ka konsensus për një proces të dialogut kur nuk ka konsensus pikë se pari të një mazhorance.

**Zenun Pajaziti:** Jo rrallë kemi pas raste të tilla të aktivitetit tonë në Kuvend me kësi nguti dhe me kësi procese pak të përshpejtuara dhe disa prej tyre kanë qenë më të

rëndësishme e disa tjera më pak të rëndësishme. Unë e votoj këtë, e votoj se ky farë procesi është si është, dhe nuk mendoj që tash i bëjmë mirë me stopuar dhe është më mirë me i dhënë njëfarë ngjyrimi ligjor.

Personalisht si shumë deputetë kemi shume vërejtje për krejt procesin, me një konsensusi tonin brenda spektrit politik, e brenda asaj marrëveshje në parim me fillua me hartuar një ligj, dhe me filluar me i zgjedh njerëzit, me i emërua aty, në përputhje me këtë ligj, me kualitete që i duhet këtij procesi, me seriozitetin që i duhet këtij procesi, dhe me përfaqësimin që i duhet këtij procesi, kishte qenë më mirë. Ne nuk jemi në atë fazë, ne jemi në një fazë ku edhe me bërë këtë ligj nëse ka ngërç politik në qëndrimet politike që janë të shfaqura në Kosove, asgjë nuk na duhet ky ligj. Unë po e marr si tendencë, si përpyekje, që me këtë ligj, ndoshta edhe me i zhbllokuar disa ngërçe që janë.

Tash ky ligj është ky që është, me këtë hapësirë sa kemi pasur. Tash kjo nëse ka anti-kushtetuese diçka, nuk besoj që ecë përpara, e kemi kontestuar krejt Presidentin edhe opozita, që s'ka të drejtë me u marrë me këto gjëra, e tash kur po e bëjmë një delegacion shtetëror, me mundësinë që me u përfaqësuar të gjithë këtu, tash qenka jo kushtetuese se po i merr kompetencat edhe të Presidentit. Mendoj që kjo është një përpyekje solide e mirë, brenda nesh, me mujt me i grumbullua sa ma mirë njerëzit me i dhënë përgjegjësi brenda kësaj kornize kushtetuese që e kemi. Unë besoj që sfidat në prekje të kushtetutës mund t'i kemi ma vonë, unë ju ftoj të gjithëve, besoj që kemi me qenë të përgjegjshëm mos me ra në gracka të tilla, por sido që të jetë, po e them edhe njëherë pavarësisht procesit qysh shkon, unë e shoh pozitive dhe e shoh më shumë pozitive sesa mënyrën qysh po e votojmë, e qysh e qesim në Kuvend. E shoh ndoshta si një shteg të lidhshpimit politik për me u nxjerr, për me bërë një hap përpara, nëse s'e bëjmë ata, ne e bëjmë edhe një ligj tjetër, dy ligje tjera.

**Kryetarja**, natyrisht po e deklaroj edhe unë qëndrimin tim, që vota ime do të jetë pro ndoshta vetëm për shkak të disa argumenteve që do t'i them edhe në seancë, për shkak të asaj që përherë ky Kuvend ka kërkuar që të përkrahët në procesin e dialogut dhe të jetë i përfshirë në këtë proces. Ne fakt, ajo që unë e vlerësoj pozitive brenda tij është që janë të përcaktuara në nenin 8, përfaqësuesit e të gjitha subjekteve parlamentare përfshirë edhe opozitën, që mendoj që është një rast shumë i mirë që partitë opozitare ta kenë rolin e tyre mbikëqyrës në komisionin ad-hoc i cili do të përzgjidhet me këtë projektligj.

Po ashtu është shumë e rëndësishme që një komision brenda Kuvendit do të udhëhiqet nga opozita që do ta ketë rolin e tij mbikëqyrës, kjo mendoj që i jep një mbështetje shumë të madhe rolit mbikëqyrës dhe e fuqizon Kuvendin si institucion. Gjithsesi brenda Rregullores së punës së Kuvendit që është e përcaktuar, për të mos qenë bllokues po për të pa që ne do të kujdesemi që të mos ketë cenim të Kushtetutës. Gjykata Kushtetuese është një institucion që mundet t'i drejtohet secili deputet nëse ka cenim brenda këtij Projektligji dhe brenda obligimeve që ne i marrim si institucione.

Pas diskutimeve e hodhi në votim Projektligjin, pas votimit konstatoj se komisioni me shumicë votash (5 për dhe 1 kundër) nxori këtë:

### **Rekomandim**

Projektligji nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësit dhe kompetencat e Delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk janë në kundërshtim me legjisllacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 17:00.

**Përgatitur nga**  
**Njësia për Mbështetjen e Komisionit**

**Kryetare e Komisionit**  
**Blerta Deliu-Kodra**

-----